

## **Agjencia e Punësimit për Gratë dhe Vajzat**

Ka filluar funksionimin në Prill të vitit 2003 dhe ofron shërbime nëpër shtëpi për punonjëse shtëpie, infermiere, kujdestare të moshuarish dhe kujdestare fëmijësh. Në fokusin e këtij projekti janë gratë dhe vajzat më në nevojë, të cilat nuk kanë shumë mundësi për të zgjedhur. Qëllimi kryesor i funksionimit të kësaj agjencie është aftësimi dhe punësimi i grave dhe vajzave në nevojë, puna për realizimin e së cilit ka bërë të mundur edhe zbutjen e papunësisë, përfshirja e shërbimeve të reja në praktikën e jetës komunitare, zgjerimi i tregut të punës, si dhe rritja e vetëvlerësimit dhe e shoqërizimit të këto gra.

Shumë prej këtyre grave vazhdojnë të frekuentojnë Klubin e shoqatës duke marrë pjesë në aktivitetet dhe takimet e ndryshme të zhvilluara aty. Gjithashtu, numri i klientëve që kanë kërkuar shërbimet tona, ka ardhur duke u rritur.

ka filluar funksionimin në Prill të vitit 2003.

- Gjatë periudhës 3 vjeçare, Agjencia është frekuentuar nga një numër i konsiderueshëm grash, prej të cilave janë përzgjedhur dhe trajnuar 230 gra dhe rreth 30% e tyre kanë provuar punësimin nëpërmjet Agjencisë

## **Financuar nga Caritas St. Poltten .**

### **Çfarë ofrohet nga agjencia?**

- Agjencia jonë, me anë të grave dhe vajzave të trajnuara, ofron në familje shërbimet e mëposhtme:
  - kujdestari për fëmijët e çdo moshe, për çdo moment të ditës.
  - kujdestari për të moshuarit me ose pa probleme.
  - kujdestari për persona të sëmurë.
  - asistencë shtëpiake (mirëmbajtje të banesës, institucionit apo pallatit)

Gratë dhe vajzat që trajnohen dhe punësohen nga kjo agjenci si dhe klientët që provojnë shërbimet tona, ndihen më të sigurt dhe më të mbrojtur. Kjo arrihet me anë të akt – marrëveshjes që përpilohet dhe firmoset nga të tre palët: punëmarrës, punëdhënës dhe agjencia.

### **Kriteret e pranimit të target grupeve.**

1. Të jenë 25 – 45 vjeç.
2. Të mos jenë në marrëdhënie pune.
3. Preferohen të kenë arsim të mesëm
4. Preferohen të kenë eksperiencë pune,
5. Për infermieret dhe kujdestaret e fëmijëve nevojitet diploma si infermiere ose mësuese.

Momente te trajnimit te grave nga Agjencia.



Certifikimi i grave pas trajnimit nga Agjencia.





Momente pune te grave te trajnuara nga Agjencia.

